REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**
**Sekretaria**

Nr._____Prot. Tiranë, më 25.11.2026

**MBLEDHJA Nr. 51,**
**Datë 27.11.2026, ora 11:00**
**e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 59/2026, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*"; (ii) nenit 9, të "*Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë* (ERE)", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të "*Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 27.11.2026, ora 11:00,** do të zhvillohet mbledhja nr. 51 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e "OSSH" sh.a. për shqyrtimin e Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

2. Mbi kërkesën e shoqërisë "Power – Elektrik - Slabinje" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

3. Mbi kërkesën e shoqërisë "Sunny Side Energy" sh.p.k. për regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

4. Mbi kërkesën e shoqërisë "KURUM INTERNATIONAL" sh.a. për shfuqizimin e vendimit nr. 07, datë 06.02.2014, "Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të HEC "ULËZ"- "SHKOPET", "BISTRICA 1" dhe "BISTRICA 2".

5. Mbi përfundimin e procedurës së filluar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 213, datë 28.07.2026, "Për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "HIDROINVEST 1" sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me konfigurimin teknik të lidhjeve 35 kV në transformatorin TR-1 të nënstacionit Prrenjas".

6. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**
**Petrit AHMETI**